



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 406, datë 09.10.2020

PËR

**KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATIT TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN
E MAGJISTRATURËS, Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 09.10.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë, *subjektet ex officio*, që kanë mbaruar vitin e dytë në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, përcjell nga Shkolla e Magjistraturës me Shkresën nr.459 prot., datë 09.07.2020, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr. 3210 prot., datë 09.07.2020.

2. Në funksion të verifikimit në kohë të kushteve dhe kriterëve të emërimit për magjistratët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t’i dërgohen Këshillit, me qëllim emërimin e tyre brenda afatit që ligji përcakton, me Vendimin nr.122, datë 05.03.2020, mbështetur në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve*

ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Ilir Toska.

3. Më datë 10.03.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, më datë 12.03.2020, Këshilli pezulloi të gjitha afatet dhe procedurat e filluara, duke rifilluar veprimtarinë e tij me Vendimin nr. 142, datë 22.04.2020, “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”. Në pikën 4 të këtij vendimi, Këshilli vendosi rifillimin e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020. Për rrjedhojë, më datë 23.04.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati z. Jahjollli, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatis për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 04.05.2020, 13.05.2020 dhe 12.06.2020, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, subjekte këta që kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionin e tyre më datë 06.05.2020, 14.05.2020, 21.05.2020 dhe 28.05.2020, me përjashtim të një subjekti (siç do të përshkruhet më poshtë).

8. Gjatë procedurës së verifikimit, në datën 29.04.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 29.04.2020, mbas administrimit të dokumentacionit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës për kandidatët që priteshin të diplomoheshin në vitin akademik 2019-2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët e vetëdeklarimeve në lidhje me anëtarësinë në parti politike, me disiplinën në punë (qenien ose jo i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për pasjen ose jo masë disiplinore në fuqi), si dhe me qenien ose jo bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, të cilët duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit tregues, kandidati z. {...} depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët përkatës të vetëdeklarimeve.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTIN DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI GJYQTAR

A. Për kushtin e emërimit si gjyqtar

12. Sipas pikës 1, të nenit 136/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit”*. Pra, rekrutimi i gjyqtarëve sipas Kushtetutës mund të bëhet vetëm mes atyre individëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.

13. Sipas nenit 244, të Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si funksion i Shkollës së Magjistraturës përcaktohet dhe ai i formimit profesional të magjistratëve, që përfshin programin e formimit fillestar (3-vjeçar) të kandidatëve për magjistratë dhe atë të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

14. Ndërkohë, Ligji për Statusin (Krerët I dhe II, Pjesa III), në lidhje me zhvillimin e karrierës së magjistratëve, si kusht për rekrutimin/emërimin si magjistrat përcakton përfundimin e formimit fillestar për magjistrat dhe diplomimin në Shkollën e Magjistraturës.

15. Ndjekja e formimit fillestar (3-vjeçar) për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës rregullohet nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ndërsa pranimit në këtë program formimi realizohet mbi bazë konkurrimi mes atyre që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligjin për Statusin (neni 28).

16. Si përjashtim nga rregulli, Ligji për Statusin, në dispozitat kalimtare, pikërisht në nenin 165¹, ka parashikuar mundësinë e ndjekjes së një programi trajtimi (2-vjeçar) në Shkollën e Magjistraturës nga subjekte të një kategorie të caktuar, ku përfshihen edhe ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative të cilët, sipas pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së

¹ “1. Këshilltari i gjyqararit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqararit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

...

4. Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë: a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës; b) të caktohen brenda afatit 1-mujor pas përfundimit të programit të trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33, të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim; c) të përfitojnë gjatë periudhës dyvjeçare të trajnimit, të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqararit.

5. Ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqararit, në kuptim të pikës 4, të këtij neni, marrin pjesë në provimin përfundimtar në përmbyllje të vitit të tyre të parë në Shkollën e Magjistraturës. Ata caktohen për praktikë profesionale dhe vlerësohen gjatë saj, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.

6. Në përfundim të trajnimit dyvjeçar, ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqararit, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, renditen sipas rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ata përfshihen në listën e renditjes dhe emërohen si magjistratë, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse marrin të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe janë vlerësuar të paktën “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale.

7. Shkolla e Magjistraturës miraton rregullat për procedurën dhe kushtet për pjesëmarrjen në provimin përfundimtar, kurrikulën dhe pjesëmarrjen në kurset e trajnimit.

...”

Shqipërisë dhe Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, klasifikohen si subjekte rivlerësimi *ex officio*. Për këtë kategori subjektsh, në rast të arritjes së paku të 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, Ligji për Statusin ka njohur të drejtën për të ndjekur fushën e karrierës së magjistratit, pikërisht duke parashikuar mundësinë e tyre për të marrë pjesë në një program trajnimi të veçantë 2-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të të cilit, *nëse arrijnë të marrin të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe vlerësohen të paktën “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale*, ata gëzojnë të drejtën për t’u emëruar si magjistratë. Në çdo rast, për të vijuar ndjekjen e programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, subjektet e kësaj kategorie duhet të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Marrja ndaj tyre të masës së shkarkimit nga organet e rivlerësimit kalimtar, passjell ndërprerjen e programit të trajnimit dhe përjashtimin e subjektit nga ky program.

17. Z. {...} bën pjesë në këtë kategori të veçantë kandidatësh për magjistratë (profili gjyqtar), ndërsa ka qenë në detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, shkak për të cilin ka qenë subjekt rivlerësimi kalimtar *ex officio*. Për këtë shkak, në kuadër të këtij procesi, z.{...} i është nënshtruar testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, në datat 7-8 maj 2018, në përfundim të të cilit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me Vendimin nr. 17, datë 21.05.2018, ka miratuar rezultatet e të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, referuar të cilëve, ai ka arritur të marrë më shumë se 60 për qind të pikëve të këtij testi. Mbi këtë bazë, z.{...} ka zgjedhur të ndjek fushën e karrierës së magjistratit, ndërsa ka marrë pjesë në programin e trajnimit 2-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës sipas të drejtës së njohur nga neni 165 i Ligjit për Statusin. Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me Vendimin nr. 96, datë 09.01.2019, ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë...”. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar, më datë 26.02.2019.

18. Bazuar në Vendimin nr.16, datë 29.06.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjell me Shkresën nr.459 prot., datë 09.07.2020, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati në fjalë ka përfunduar programin e trajnimit 2-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe në përfundim të vitit akademik 2019-2020 është diplomuar për magjistrat, profili gjyqtar:

- a) me 94.92 % të pikëve, pra “*ka marr të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë*”;
- b) është vlerësuar me 589.92 pikë, domethënë “shumë mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale, pra “*është vlerësuar të paktën "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale*”.

19. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit si gjyqtar.

B. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

20. Sipas pikës 2, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “*Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj*”. Kriteret e tjera janë përcaktuar në Ligjin për Statusin, ndërsa ato, si dhe më lart u parashtrua, verifikohen që në momentin e pranimit në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës.

21. Ndërkohë, për ndjekjen e programit të trajnimit 2-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës nga subjektet e kategorisë së veçantë sipas nenit 165 të Ligjit për Statusin, ky i fundit kërkon vetëm qenien e tyre në detyrë si këshilltar i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, si ndihmës ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ndërsa nuk gëzojnë statusin e gjyqtarit ose prokurorit dhe janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pra, për këtë kategori subjektesh ligji nuk ka përcaktuar si kritere pranimi në programin e trajnimit 2-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

22. Gjithsesi, kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit, përveç se përcaktohen si kritere të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen gjithashtu edhe si kritere zgjedhshmërie, pra si kritere që magistrati (gjyqtari) do të duhet t’i plotësojë në momentin e emërimit dhe gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit, referuar për këtë neneve 64 dhe 66 të këtij ligji.

23. Nisur nga kjo, ndërsa në rastin konkret ndodhemi para rekrutimit si gjyqtar të kandidatit z. {...}, në përmbushje të detyrimit konstant të verifikimit të kritereve të zgjedhshmërisë, për atë u verifikuan disa nga kriteret sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, të cilat konsiderohen relevante në momentin e rekrutimit/emërimit të magistratëve apo mbesin të tilla përgjatë gjithë zhvillimit të karrierës së tyre për shkak të qenies potencialisht të ndryshueshëm.

24. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikuan këto kritere:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për këtë kriter, për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësia shqiptare*. Për këtë kriter, në dosjen e kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës gjendet dokumenti “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 07.01.2020, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast

pasqyrohet “shqiptar”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 01.07.2020, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) gjendja gjyqësore. Për këtë kriter, në dosjen e kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës gjendet një verifikim i bërë nga kjo e fundit në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), për të cilin është printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 19.04.2018. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr.4314/2 prot., datë 07.05.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) disiplina në punë. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga kandidati në jetëshkrimin (CV) e depozituar në Shkollën së Magjistraturës, u konstatua se ai ka qenë i punësuar përpara fillimit të Shkollës si vijon: - për periudhën 16 prill 2009-28 shtator 2011, “jurist” pranë Avokaturës së Shtetit; - për periudhën 29 shtator 2011-30 gusht 2012, “specialist” dhe “inspektor” pranë Ministrisë së Drejtësisë; - për periudhën 30 gusht 2012-01 mars 2014, “Drejtor Juridik”, “Drejtor në Drejtorinë e Marrëveshjeve”, “Përgjegjës sektori” pranë Ministrisë së Brendshme; - për periudhën 01 mars 2014-01.10.2018, “këshilltar ligjor” pranë Gjykatës së Lartë. Nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr.2300/1 prot., datë 07.05.2020, rezulton se kandidati {...} ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën janar 2012-gusht 2012; ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Brendshme dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën shtator 2012-shkurt 2014; ka qenë i punësuar pranë Gjykatës së Lartë dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën mars 2014-shtator 2018. Ndërkohë, nga përgjigja e ardhur nga ky institucion rezulton që kandidati të ketë punuar me kohë të pjesshme edhe pranë subjektit shoqërisë “ERTA” sh.p.k. për periudhat shkurt 2014-korrik 2014. Ndërkohë, referuar të dhënave përpara janarit 2012, nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Arkivit Qendror, me Shkresën nr. 3352/3 prot., datë 27.05.2020, rezulton se kandidati ka qenë i punësuar pranë Avokaturës së Shtetit dhe për të janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën prill 2009-shtator 2011. Sipas Shkresës nr.1679/1 prot., datë 21.05.2020, Avokatura e Shtetit informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 16.04.2009 deri në datën 28.09.2011 dhe në ngarkim të tij nuk figurojnë masa disiplinore. Sipas Shkresës nr. 2750 prot., datë 14.05.2020, Ministria e Drejtësisë informon se kandidati {...} ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj për periudhën 29.09.2011 deri në datën 30.08.2012 dhe nuk rezulton te ketë marrë asnjë masë disiplinore. Sipas Shkresës nr. 3245/1 prot., datë 28.05.2020,

Ministria e Brendshme informon se kandidati {...} ka punuar pranë këtij institucioni nga data 30.08.2012 deri më datë 01.03.2014 dhe në dosjen e tij personale nuk administrohen masa disiplinore apo informacione të tjera që të ketë cenuar marrëdhëniet e punës. Ndërsa sipas Shkresës nr.855/1 prot., datë 06.05.2020, Gjykata e Lartë informon se kandidati {...} gjatë periudhës së ushtrimit të ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë ndaj tij, nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Ndërkohë, informacioni i nevojshëm dështoi të merret nga ish-punëdhënësi i kandidatit, Shoqëria "Erta"sh.p.k, subjekt ky që sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrin tregtar elektronik në administrim të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka pasur si objekt veprimtarie, ndër të tjera, edhe hapjen e kurseve të specializimit dhe kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë, në fusha të ndryshme, në Universitetin Jopublik "ILLYRIA", pikërisht institucioni arsimor pranë të cilit kandidati ka qenë i punësuar. Referuar të dhënave të regjistrin tregtar elektronik, shoqëria tregtare në fjalë është me status të pezulluar², prej datës 21.10.2014, shkak për të cilin nuk u bë e mundur komunikimi me të. Vlen të përmendet se, me Vendimin nr. 539, datë 06.08.2014, "Për heqjen e liçencës disa institucioneve private të arsimit të lartë", Këshilli i Ministrave i ka hequr liçencën edhe institucionit privat të arsimit të lartë "Shkollës së Lartë "Illyria"³, që korrespondon pikërisht me kohën kur kandidati ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë subjekt.

d) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim, në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e tij anëtar i ndonjë partie politike;

dh) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Për këtë kriter u mbajt në konsideratë mosha e kandidatit (i datëlindjes 11.10.1979), çka bën të panevojshëm verifikimin e këtij kriteri pranë autoritetit të ngarkuar nga ligji (Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), sikurse përcaktohet edhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019;

e) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim, në të cilën deklaroi se nuk ka qenë dhe nuk është bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e tij bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

24.1. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson kriteret e kandidimit/emërimit si gjyqtar, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

C. Për kriterin e pasurisë

² Shiko për më tepër: file:///C:/Users/user/Downloads/EkstraktIThjeshte-10_2_2020.pdf

³ Shiko për më tepër: http://sporti.gov.al/ep-content/uploads/2018/07/VKM_per_heqjen_e_licences.pdf

25. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, sikundër kërkohet nga pika 1, e nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se: *“Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit”*. Ndërkohë, verifikimi i pasurisë edhe për kandidatët për magjistratë rregullohet në nenin 32, të Ligjit të Statusit.

26. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për emërimin e tyre si gjyqtarë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin 75/2019. Pasur parasysh faktin se përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe disa subjekte të tjerë, përfshirë edhe ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, do të rivlerësohen *ex officio*, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për subjektet e rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, ose emërimin e tyre rishtazi sipas nenit 165 të Ligjit për Statusin, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

27. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr.84/2016”, përcaktohet se: *“1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, do t'i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr.9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë. 7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij*

vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

28. Sa më sipër, kandidati për magjistrat, profili gjyqtar, për t’u emëruar gjyqtar, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatit që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në kuadër të verifikimit të figurës, ky kandidat i nënshtrohet verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

29. Rezulton se kandidati, z. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 96, datë 09.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, marrë formë të prerë, pa u ankimuar, më datë 26.02.2019. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë për këtë kandidat u shtri për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tij në detyrë.

30. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 152/24 prot., datë 25.06.2020.

31. Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

32. Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

33. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

33.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 7363/1 prot., datë 15.05.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

33.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 8001/1 prot., datë 20.05.2020, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

34. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

35. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

Ç. Për kriterin e figurës

36. Për kandidatin {...} u verifikua edhe kriteri i figurës, duke vlejtur për këtë sa është parashtruar në pikat 25 - 29, të këtij vendimi. Edhe për kriterin e figurës, verifikimi i kandidatit u shtri për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tij në detyrë.

37. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi

vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit⁴, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni⁵.

38. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

39. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 27.04.2020, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

40. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 668/24 prot., datë 12.06.2020, të gjithë informacionin e kërkuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Nga këto verifikime, nuk rezulton që për kandidatin të jetë regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim si dhe nuk rezulton të jetë i përfshirë në krimin e organizuar, i dënuar ose proceduar penalisht brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

41. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 3338/1 prot., datë 08.07.2020, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, për kandidatin {...}, është bërë me dije se *“shtetasi për të cilin kërkohet informacion nga ana juaj, rezulton me përbërësit e gjendjes civile (emër, mbiemër) “{...}”, lindur më datë 11.10.1979, emri i babait “Shpëtim”, emri i nënës “Drita”. Për shtetasin në fjalë konstatojmë se sipas aktit të lindjes nr. 101, dt. 12.12.1979 mbiemri rezulton “Jaholli”*”.

42. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet

⁴ Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

⁵ Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

e rastit, konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua se kishte vend për verifikim të mëtejshëm nga Prokuroria e Përgjithshme, duke iu kërkuar kjo përmes Shkresës nr.1960/2 prot., datë 16.07.2020.

42.1 Në përgjigje të kërkesës së Këshillit për verifikim shtesë, Prokuroria e Përgjithshme, me Shkresën nr. 768/150 prot., datë 29.09.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.3647/40, datë 30.09.2020, informon se pas kërkesës për verifikim, verifikimit të kryer dhe rrethanat/faktit rezultuar, ka vendosur: *“I. Miratimin e rezultateve të verifikimit, në lidhje me subjektin {...} Shpëtim{...}, kandidat për magistrat, i cili, si më poshtë: i. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për kryerjen e ndonjë vepre penale; ii. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për ndonjë çështje penale; iii. Nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale; iv. Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale; v. Nuk rezulton të ketë indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion, me qëllim verifikimi: - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; - për qenien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj; - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij; - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera; vi. Rezulton të ketë patur mbiemrin “Jaholli”, në aktin e lindjes më datë “12.12.1979” dhe në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, “Gjon Kastrioti”, me referencë 1/94. Në ndryshim nga anëtarët e tjerë të familjes të cilët kanë rezultuar të regjistruar me mbiemrin “Jahjulli”; vii. Rezulton të ketë mbiemrin “Jahjulli”, në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë të vitit 1974, “Pandi Dardha”, me referencë 22-85, me vendosjen e familjes më vete nga trangu i origjinës...”*

43. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;

- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë për emërim si gjyqtar.

III. KONKLUZIONE

44. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

45. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 dhe 165 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019 - 2020 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR